

P.nr.1533/13

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin e vetëm gjykues Naser Foniqi dhe procesmbajtësen Sevdije Breznica, në çështjen penale të të pandehurit M.B, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378, par. 7, lidhur me par. 6 dhe 1, të KPRK, të akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.nr.7801/2012, të datës 05.04.2016, jashtë seancës, me datë 31.03.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.nr.7801/2012, të datës 05.04.2016, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMORË

I pandehuri M.B, i biri i S, i lindur me *data e lindjes*, nga P, rr. "...", hyrja ., nr., me numër personal *numer personal*, shqiptar, – shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

S e p s e: me datë 21.10.2012, rreth orës 22:20, në Prishtinë, në kryqëzimin e rrugëve "Agim Ramadani dhe Fehmi Agani", derisa ka qenë duke e drejtuar veturën e markës "O A", ngjyrë hiri, me targa ..-...-..., nga pakujdesia, ka rrezikuar trafikun publik dhe ka dëmtuar trupin e njeriut, duke vepruar në kundërshtim me nenin 64 të LSKRR, ashtu që, derisa ka qenë duke qarkulluar në rr. "Agim Ramadani", ka hyrë në kryqëzimin e rregulluar me semafor dhe duke mos respektuar përparësinë e kalimit të automjetit, në pamundësi që ta ndaloj automjetin e tij, me pjesën e përparme të anës së majtë ka goditur në pjesën e përparme të anës së majtë automjetin e tipit "S O", ngjyrë hiri, me targa ..-...-..., të cilin e drejtonte tani i dëmtuari Xh.K, i cili si pasojë e këtij aksidenti ka pësuar lëndime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin, si dhe është shkaktuar dëm material në automjetin e të dëmtuarit,-

-me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378, par. 7, lidhur me par. 6 dhe 1, të KPRK.

Andaj, gjykata konform neneve 41, 46 dhe 73, të KPRK, si dhe neneve 365 e 495, të KPP, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

- Në shumë prej **treqind (300) €**, të cilin dënim, i pandehuri obligohet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.
- Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, me pëlqimin e të pandehurit gjykata do ta zëvendësoj dënimin me gjobë në urdhër për punë në dobi të përgjithshme, e nëse i dënuari nuk e jep pëlqimin gjykata do t'i caktoj një ditë burgimi për 20 € të gjobës.
- Obligohet e pandehura të paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas listës së shpenzimeve dhe atë: për ekspertizën mjeko ligjore të paguaj

shumën **20.44€**; për ekspertizën e komunikacionit të paguaj shumën **40.88 €**, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **tridhjetë (30) €**, në afat prej 15 ditësh, por jo me shumë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.

- **I dëmtuari Xh(H)K**, nga fshati H, Komuna O, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Pas kallëzimit penal të Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor në Prishtinë nr.2012-AR-1867, të datës 21.10.2012, Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.nr.7801/2012, të datës 05.04.2016, e ka akuzuar M.B, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378, par. 7, lidhur me par. 6 dhe 1, të KPRK, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimorë – dënim me gjobë, me arsyetimin së ka prova të mjaftueshme, me të cilat vërtetohet dyshimi i bazuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale, për të cilën është akuzuar.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPP, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPPK, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë: raporti i aksidentit nr.2012-AR-1867, i datës 21.10.2012; ekspertiza mjeko-ligjore, e Dr. N.U, e datës 28.02.2013; Ekspertiza e komunikacionit e A.K, e datës 07.03.2013; deklarata e tani të dëmtuarit Xh.K, e dhënë në polici me datë 22.10.2012; deklarata e ngasësit – tani të pandehurit M.B, e dhënë në polici me datë 22.10.2012; si dhe fotografitë e vendit të ngjarjes, janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u mor konform nenit 450, të KPPK.

Pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë, në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPK, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.1533/13, datë 31.03.2016.

Procesmbajtëse,
Sevdije Breznica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Naser Foniqi

KËSHILLË JURIDIKE:

I pandehuri ose mbrojtësi i tij, në afat prej tetë (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimorë, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.